



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Armend Mehaj, Ministër

Adresa: Kazerma " Adem Jashari "10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes (MM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Mbrojtjes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mbrojtjes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Ministria e Mbrojtjes ka kontratë të lidhur për shërbimet e ushqimit, ku bënë furnizim, përgatitje dhe servim në të gjitha kuzhinat e FSK-së. Vlera e pagesave për vitin 2020 për këtë shërbim ishte 2,218,317€. Sipas Ligjit për shërbimin e FSK-së, vetëm “Pjesëtari aktiv” i FSK-së ka të drejtë të ushqimit, përderisa racionet/ushqimin në kuzhinë, përveç pjesëtarëve aktiv të FSK-së, i shfrytëzojnë edhe administrata civile.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

1 Gjatë auditimit në kategorinë e investimeve kapitale, mostrimi ka përfshirë edhe 15 mostra në vlerë prej 14,756,768€ të cilat takojnë kategorisë së informatave të klasifikuara dhe për këtë arsye këto mostra/pagesa nuk i kemi audituar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mbrojtjes.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Mbrojtjes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se menaxhimi i shpenzimeve ka nevojë për përmirësim. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do ti përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Shfrytëzimi i kuzhinës nga administrata

Gjetja Neni 16 paragrafi 1 i Ligjit nr. 06/l-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës përcakton se: “Pjesëtari aktiv i FSK-së ka të drejtë për së paku një racion të ushqimit, gjatë secilit orar të plotë të punës (e përcaktuar si çdo periudhë e qëndrimit të vazhdueshëm në detyrë për më shumë se gjashtë (6) orë në çdo dymbëdhjetë (12) orë”.

Te kontrata e lidhur për Shërbimet e ushqimit (furnizim, përgatitja dhe servimi) nëpër të gjitha kuzhinat e FSK-së, ku vlera e shpenzimeve për vitin 2020 ishte 2,218,317€, kemi vërejtur se përveç pjesëtareve aktiv të FSK-së të cilët kanë të drejtë ta shfrytëzojnë një racion të ushqimit, në kuzhina janë ushqyer me nga një racion edhe stafi civil të cilit sipas ligjit nuk i takon të ushqehet në kuzhinë. Çmimi i një racioni është 4.75€ dreka, ndërsa racionet për mëngjes 1.26€ dhe darka 2.78€.

Nga MM nuk kemi pranuar ndonjë arsye pse stafi civil e shfrytëzon të drejtën e ushqyerjes në kuzhina dhe pse janë paguar këto shpenzime.

Ndikimi Shfrytëzimi i kuzhinës së FSK-së nga stafi civil ndikon në rritjen e numrit të racioneve të ushqimit dhe kryerjen e pagesave të parregullta nga ministria.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar se shërbimet e kuzhinës (racioni i ushqimit) do të shfrytëzohen vetëm nga pjesëtarët aktiv të FSK-së ashtu siç e parash Ligji e jo edhe nga stafi civil.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshi dhe komunalit) në vitin 2020 ishte 10,251,896 €, prej tyre ishin shpenzuar 9,209,659€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me Furnizim me ushqim dhe pije(jo dreka zyrtare), mirëmbajtje dhe riparime, karburante për vetura dhe naftë për ngrohje qendrore, furnizim me veshmbathje, furnizim me pajisje specialistike mjekësore dhe pajisje tjera. Kemi testuar 16 mostra për teste substanciale në vlerë 2,227,437€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Vonesat në liferimin e mallit

Gjetja

Në kontratën për “Furnizim me pajisje, reagenca dhe material mjekësor për nevojat ekstreme emergjente të FSK-së” në nenin 2 pika 2.1 thuhet që afati i liferimit është maksimumi 15 ditë nga momenti i marrjes së urdhër blerjes. Po ashtu, në nenin 16.1 thuhet që, nëse furnizuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të kontratës, për çdo ditë vonesë.

Në realizimin e kontratës për furnizim me pajisje, reagenca dhe material mjekësor për nevojat ekstreme emergjente të FSK-së në vlerë prej 106,467€, ka pasur deri në 157 ditë vonesa në liferim. Prej tyre: fletë dërgesa 1365/2 është liferuar me datë 10.07.2020 dhe ka 29 ditë vonesë, fletë dërgesa 1365/3 është liferuar me datë 08.09.2020 dhe ka 89 ditë vonesë, fletë dërgesa 1365/4 është liferuar me datë 22.09.2020 dhe ka 103 ditë vonesë, fletë dërgesa 1365/5 është liferuar me datë 08.10.2020 dhe ka 119 ditë vonesë, fletë dërgesa 1365/6 është liferuar me datë 21.10.2020 dhe ka 132 ditë vonesë, dhe fletë dërgesa 1365/7 është liferuar me datë 16.11.2020 dhe ka 157 ditë vonesë. Edhe përkundër të gjitha këtyre vonesave, ministria nuk kishte aplikuar gjokat ndaj OE, siç parashihej me kontratë.

Kjo ka ndodhë si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në ministri.

Ndikimi

Vonesat në ofrimin e mallit, veçanërisht në këtë rast ku kërkesa ishte ekstreme emergjente për furnizim me pajisje, reagenca dhe material mjekësor mund të ndikoj në performancën e organizatës dhe arrijen e objektivave të sajë. Për më tej, mos aplikimi i penaltive/gjobave për vonesë të furnizimeve është mosrespektim i kushteve të kontratës dhe dëmtim i buxhetit të MM-së.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të rishikoj procedurat të cilat ndikojnë në funksionimin e kontrolleve të brendshme për të identifikuar arsyet e mos zbatimit të kërkesave të kontratës dhe të siguroj që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - MM nuk kishte hartuar ndonjë procedurë për monitorimin e kuzhinës

Gjetja Neni 16 paragrafi 4 i Ligjit nr. 06/l-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës përcakton se. "Rregullat për ushqimin, transportin dhe akomodimin, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri".

Ministria nuk kishte hartuar ndonjë akt të veçantë nënligjor që ka të bëjë me monitorimin e stafit që ushqehen në kuzhina. Ne kemi vërejtur se menaxheri i kontratës i pranon kërkesat nga njësitë kërkuese për numrin e personave që do të ushqehen nëpër kuzhina dhe në bazë të numrit të pranuar, i bënë kërkesë kuzhinave për racionet që duhet të përgatiten. Ministria nuk ka ndonjë mekanizëm monitorues për të verifikuar numrin e personave që ushqehen nëpër kuzhinat e FSK-së, respektivisht nuk bën ndonjë kontrollë/verifikim nëse po ushqehen të gjithë personat sipas porosive që bëhen nga menaxheri i kontratës. Operatori ekonomik faturimin e bënë sipas porosisë për numrin e personave të pranuar nga menaxheri i kontratës.

Kjo ka ndodhë si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në ministri për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kuzhinave.

Ndikimi Mungesa e një monitorimi për të verifikuar numrin e personave që ushqehen nëpër kuzhina mund të ndikoj që ministria të bëjë pagesa përtej nevojave reale të stafit.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të hartoj aktet e veçanta nënligjore me të cilat rregullohet procedurat për monitorimin e kuzhinave në FSK në mënyrë që të evitohen keqpërdorimet e mundshme në procesin porosisë dhe marrjes së shërbimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2020 ishte 28,912,752€, prej tyre ishin shpenzuar 24,543,734€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtesat, pajisjet ushtarake, pajisje të teknologjisë Informative, pajisje mjekësore dhe pajisje tjera. Kemi testuar 24 mostra për teste substanciale në vlerë 5,781,407€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Pagesa për furnizim me automjete jo në pajtim me kontratën

Gjetja Sipas kontratës ndërmjet MM-së dhe OE për furnizim me automjete taktike me pajise shtesë, neni 4 çmimi, pika 2 thekson që kursi mesatar i këmbimit (USD/EUR) duhet të merret nga BQK ose nga Banka Evropiane në ditën e nxjerrjes së urdhër blerjes dhe të gjitha pagesat do të bëhen në euro. Çmimi i një automjeti sipas kontratës ishte 255,811\$.

Kemi vërejtur se ministria nuk e kishte përlogaritur kursin e këmbimit valutor ashtu siç ishte kërkuar me kontratë, me datën e urdhërblerjes.

Për pagesën e realizuar me datë 18.08.2020, këmbimi valutor ishte bërë më datë 27.07.2020, ku vlera e këmbimit në këtë datë ishte 1 euro = 1.16676\$. Si rezultat i këtij kursi valutor, ministria kishte paguar për 14 automjete 3,069,488€ (3,581,356\$/1,16676\$= 3,069,488€). Ndërsa, sikur të kishte paguar sipas kontratës me datë të urdhërblerjes 07.08.2020, ku vlera e këmbimit valutor në këtë datë ishte 1 euro= 1.1865 US dollar, ministria për 14 vetura do të paguante 3,018,313€ (3,581,356\$/1.186542=3,018,313€). Andaj, si rezultat i kësaj kishte paguar 60,724\$ më tepër apo shndërruar në Euro 51,177€. Vlerat e kursit të këmbimit valutor të cilave ne i`u kemi referuar janë vlera të cilat na janë ofruar nga ministria.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos respektimit të kushteve të kontratës për realizimin e pagesës në datën e urdhër blerjes nga MM-ja.

Ndikimi Mosrespektimi i kushteve të kontratës ka ndikuar në realizimin e shpenzimeve të pa arsyeshme.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të identifikoj shkaktarët e mos aplikimit të kursit valutor sipas marrëveshjes dhe të siguroj kontrolle adekuate në mënyrë që mangësitë e tilla të mos ndodhin në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e komisionit për pranimin e furnizimeve

Gjetja Neni 23 i Rregullës financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike, përcakton se "pranimi i mallit/shërbimit bëhet nga zyrtari/komisioni i autorizuar. Raporti i pranimit të mallit /shërbimit nga zyrtari/komisioni i autorizuar duhet t'i dorëzohet Zyrës për Buxhet dhe Financa së bashku me kontratën dhe urdhërblerjen".

Ne kemi identifikuar që në dy pagesa në vlerë prej 250,578€ të kontratës për pajisje mjekësore për nevojat e FSK-së nga donacioni, pranimi i furnizimeve është bërë nga menaxheri dhe ndihmës menaxheri i kontratës, në mungesë të emërimit të komisionit për pranimin e mallrave dhe shërbimeve nga ministria.

- Ndikimi** Pranimi i mallrave nga menaxherët e kontratave, dhe jo nga komisioni i pranimin i aprovuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ, është në kundërshtim me kërkesat ligjore, dhe rrit rrezikun e konfliktit të interesit pasi që nga personat e njëjtë është menaxhuar kontrata dhe janë pranuar mallrat.
- Rekomandimi B1** Ministri duhet të sigurohet që për secilin furnizim të caktohet komisioni i cili do të bëjë pranimin e mallrave sipas sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhën në mënyrë efektive. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtejshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështja 1

Pasqyrat Financiare Vjetore të Korigjuara

Gjetja

Tek Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit tek kolona e buxhetit final-hyrja e parasë së gatshme në shënimin 11 (grantet e përcaktuar të donatorëve) është prezantuar buxheti i planifikuar për shpenzim nga SIMFK e jo buxheti i planifikuar për inkasim për vitin 2020. Po ashtu buxheti fillestar për grante (500,000€), është prezantuar gabim sepse në Ligjin e Buxhetit fillestar (NR. 07/L-001) nuk ka grante të përcaktuara të donatorëve.

Buxheti fillestar dhe final tek pjesa hyrja e parasë së gatshme të hyrat vetjake, nuk ishin prezantuar sipas informimit të dërguar nga MF për projeksionet e të hyrave të datës 27.01.2021

Te ky nen, te pjesa dalja e parasë së gatshme buxheti fillestar i prezantuar në vlerë 69,776,000€, duhet të korrigohet dhe të jetë në pajtim me Ligjin e Buxhetit fillestar (NR. 07/L-001).

Veprimi i kërkuar

Menaxhmenti të marrë masa për përgatitjen e pasqyrave financiare, konkretisht të eliminoj mangësitë e evidentuara në mënyrë që PFV-të të pasqyrojnë vlerat e sakta.

Rezultati

Pas komunikimit të këtyre çështjeve menaxhmenti kishte marrë masa dhe ishin kryer përmirësimet e nevojshme.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	69,275,842.26	64,896,501.49	59,485,247.20	49,703,786.70	47,061,128.64
Grante Qeveritare - Buxheti	67,775,842.26	62,546,501.49	57,687,675.76	44,376,314.86	47,061,128.64
Te hyrat nga AKP-ja	1,500,000.00	1,500,000.00	1,297,581.44	5,327,471.84	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	850,000.00	499,990.00	0.00	0.00

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 4,379,342€. Buxheti ishte zvogëluar në vlerë prej 5,673,541€ si rezultat i ndryshimeve në Ligjin për Ndarjet Buxhetore dhe më pas ishte rritur për 1,294,199€ ku prej tyre rritja prej 444,199€ ishte bërë përmes vendimeve të Qeverisë, ndërsa rritja prej 850,000€ ishte nga donacionet e jashtme.

Në vitin 2020 MM ka shpenzuar 59,485,247 € (91.66% të buxhetit përfundimtar), me një përmirësim rreth 3.66% në krahasim me vitin 2019.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	69,275,842.26	64,896,501.49	59,485,247.20	49,703,786.70	47,061,128.64
Pagat dhe mëditjet	23,504,455.00	25,731,853.33	25,731,853.33	21,973,357.54	21,669,738.07
Mallrat dhe shërbimet	11,942,683.00	9,549,072.42	8,508,797.01	9,450,544.80	10,061,932.52
Komunalitë	938,000.00	702,823.46	700,862.00	651,461.48	671,355.47
Investimet Kapitale	32,890,704.26	28,912,752.28	24,543,734.86	17,628,422.88	14,658,102.58

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti fillestar për paga dhe mëditje ishte 23,504,455€. Krahasuar me buxhetin fillestar Buxheti final është rritur për 2,227,398€. Rritja në vlerë 2,173,710€ ishte bërë me vendim të qeverisë nr.09/50 të datës 21.12.2020, ndërsa rritja në vlerë 53,688€ ishte bërë përmes vendimit nr.01/46.


Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 2,393,611€. Zvogëlimi në vlerë 2,875,000€ ishte bërë në bazë të Ligjit nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore, ndërsa rritja në vlerë 481,389.42€ ishte bërë përmes vendimeve të qeverisë dhe një donacioni të jashtëm (36,801.93€ rritje me vendime të qeverisë dhe 444,588€ rritje nga donacioni i jashtëm i përfshirë në buxhetin final).

Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 235,177€. Zvogëlimi në vlerë prej 298,539€ ishte bërë në bazë të Ligjit nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore, ndërsa rritja në vlerë 63,362€, me vendim të qeverisë nr.09/50 të datës 21.12.2020.


Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për investime kapitale është zvogëluar për 3,977,952€. Zvogëlimi në vlerë 2,500,000€ ishte bërë në bazë të Ligjit nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore (janë anuluar 9 projekte me vlerë prej 4,050,000€ përderisa janë shtuar dy projekte në vlerë prej 1,550,000€), ndërsa pjesa tjetër e buxhetit në vlerë 1,883,364€, është zvogëluar me vendime të qeverisë dhe më pas është rritur nga donacioni i jashtëm në vlerë 405,412€.

Për më tepër, shpenzimet për menaxhimin e pandemisë (Covid 19) gjatë vitit 2020 ishin në vlerë prej 235,590€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime dhe pajisje të ndryshme mjekësore dhe pajisje tjera si dhe furnizim me veshmbathje. Ne kemi testuar tri (3) mostra në vlerë prej 141,140€, dhe si rezultat i kësaj nuk doli ndonjë çështje për ta ngritur në raport.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Sipas projeksionit të të hyrave të datës 27.01.2021, buxheti fillestar i të hyrave jo tatimore ishte 209,414€ ndërsa pas rishikimit ishte 174,235€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	209,414.00	174,235.00	114,487.54	34,526.18	30,558.47
Të hyrat jo tatimore	209,414.00	174,235.00	114,487.54	34,526.18	7,432.00
Të hyrat tjera	0.00	0.00		0.00	23,126.47

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të MM-së ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime kryesore. MM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku ka prezantuar mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna duke përfshirë personat përgjegjës dhe afatet kohore për secilin rekomandim.

Menaxhmenti i MM-së ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, ku deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, nëntë (9) rekomandime ishin zbatuar, përderisa një nuk është zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni më poshtë Tabelën e rekomandimeve.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të zyrtarëve, ose në të kundërtën, të aplikoj ndalesat në paga për mungesën e paarsyeshme në punë. Në anën tjetër, në rast të përsëritjes së gjendjes, ministri të merr masat për ndërprerjen e kontratave sipas kërkesës së ligjit për Shërbyesit Civil dhe rregullores së lartë përmendur	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar

2.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj që proceset e ndodhura brenda institucionit të dokumentohen dhe të njëjtat të ruhen sipas afatit të përcaktuar në Rregulloren e nxjerrë nga Ministria e Mbrojtjes Nr.06/2019 për menaxhimin zyrtar të dokumenteve dhe mënyrën e shfrytëzimit të materialit arkivor në arkivin e Ministrisë së Mbrojtjes.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Për të shmangur mundësinë e diktimit të çmimeve nga operatorët, Ministri duhet të vendos kontrolle më efektive në procesin e prokurimit dhe të përmirësoj komunikimin në mes zyrtarëve të përfshirë në proces, në mënyrë që procedurat e prokurimit të jenë konsistente me rregulloret, dhe jo së pari të pranohen shërbimet, e më pas të bëhen Kontratat.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të siguroj që menaxherët e projektit hartojnë raporte periodike mbi progresin e projektit, por edhe raport përfundimtar për kompletimin e kontratës, përkatësisht marrjes së shërbimeve dhe të arsyetojnë kryerjen e pagesave nga ministria.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme, në mënyrë që në të ardhmen të përgatitet dhe aprovohet plani i investimeve për nevojat themelore të mirëmbajtjes së objekteve të FSK-së, dhe se asnjë shërbim mos të kryhet pa qenë i aprovuar paraprakisht në planin e përpiluar nga ekspertët e fushës përkatëse	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurohet që për secilin furnizim të caktohet komisioni i pranimin të mallrave dhe se i njëjti të bëjë pranimin e mallrave, duke u siguruar se mallrat/pajisjet janë pranuar sipas sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.	Gjatë auditimit për vitin 2020 kemi identifikuar mangësi të tilla. Rekomandimi B1	Nuk është adresuar

8.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që komisionet për regjistrimin dhe inventarizimin e pasurisë janë kompetente, bëjnë regjistrimet dhe barazimet e duhura kontabël, si dhe përgatisin raporte të plota dhe të sakta mbi regjistrimin dhe inventarizimin e pasurisë, ashtu që kërkesat e rregulloreve për pasuritë të zbatohen me konsistencë	MM, ka formuar komisionet përkatëse për pasuri siç janë: komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurive, po ashtu ka regjistruar e pasurive jo financiare kapitale mbi 1000, jo kapitale nën 1000 dhe regjistruar e stoqeve në depo	I zbatuar
9.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet që të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit, të përcaktoj zyrtarin përkatës në mënyrë që të bëhet protokollimi i faturave sipas rregullës financiare të M.F-së nr. 01/2013.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
10.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj që pozitat e përhershme të plotësohen me vendet e lira të punës të aprovuara në ligjin e buxhetit dhe procesi i auditimit të kryhet nga stafi kompetent dhe me status të rregullt sipas kërkesave ligjore për Auditim të Brendshëm	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar se shërbimet e kuzhinës (racioni i ushqimit) do të shfrytëzohen vetëm nga pjesëtarët aktiv të FSK-së ashtu siç e parash Ligji e jo edhe nga stafi civil.
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të rishikoj procedurat të cilat ndikojnë në funksionimin e kontrolleve të brendshme për të identifikuar arsyet e mos zbatimit të kërkesave të kontratës dhe të siguroj që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të hartoj aktet e veçanta nënligjore me të cilat rregullohet procedurat për monitorimin e kuzhinave në FSK në mënyrë që të evitohen keqpërdorimet e mundshme në procesin porosisë dhe marrjes së shërbimit.
4.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurohet që për secilin furnizim të caktohet komisioni i cili do të bëjë pranimin e mallrave sipas sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të identifikoj shkaktarët e mos aplikimit të kursit valutator sipas marrëveshjes dhe të siguroj kontrolle adekuate në mënyrë që mangësitë e tilla të mos ndodhin në të ardhmen.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm




Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Florim Beqiri, Udhëheqës i Auditimit



Jusuf Kryeziu, Udhëheqës i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Kreshnike Haziri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letër Konfirmimi - Ministria e Mbrojtjes



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MBROJTJES - MINISTARSTVO OBRANE - MINISTRY OF DEFENSE			
№ Prot:	1556	№ i kopjeve:	1
№ Prot:		№ i Stranica:	
Data:	15 / 07 / 20	Data:	21
Date:		Date:	
Prishtinë / a			

Ministria e Mbrojtjes

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2020 (Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020);
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, mirëpo ju njoftoj se detyren si ministër i Ministrisë së Mbrojtjes e kemi marrë nga data 23 Mars 2021 dhe objektivi kryesor i jonë është llogaridhënja dhe transparencja;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Z. Armend Mehari
Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes

Data: 15.07.2021, Prishtinë,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.